



**Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

PESHKIM

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

J1-III-21

Tiranë, 2021

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	PESHKIM			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, nivelit III të KEK	J1-III-21
Qëllimi:	Qëllimi kryesor i kualifikimit profesional në profilin mësimor “Peshkim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, drejtimin mësimor “Detari”, është të pajisë individin me njohuritë dhe shprehjet për zhvillimin e qëndrimeve profesionale në fushën e detarisë që ka lidhje me specifikat e punës në peshkim. Këto qëndrime do t’i shërbejnë për t’i dhënë mundësinë për t’u imbarkuar në një mjet lundrimi në cilësinë e peshkatarit të kualifikuar.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin mësimor “Peshkim”, niveli III në KSHK, , referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> – kanë mbaruar drejtimin mësimor “Detari” niveli i II në KSHK, , referuar nivelit II të KEK, ku detyrimisht përvoja në det nuk duhet të jetë më pak se 2 (dy) muaj; – janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional, në veçanti në shikim dhe dëgjim. 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Peshkim”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, Drejtimin “Detari” e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të nivelit të punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Me përfundimin e këtij niveli të kualifikimit dhe me një përvojë pune në det me anijet përkatëse, jo më pak se gjashtë (6) muaj individit i lind e drejta të testohet dhe kualifikohet nga Administrata Detare si Peshkatar i Kualifikuar, Kapitulli IV/1 sipas Konventës Ndërkombëtare të STCËF-’95 ³ dhe/ose Marinar Kuverte në kualifikimin II/4 të STCË’78 ⁴ e ndryshuar. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për t’u punësuar në: <ol style="list-style-type: none"> a. mjete lundrimi për qëllime peshkimi bregdetar me gjatësi deri në 24 metra; b. mjete lundrimi për qëllime peshkimi në ujërat e brendshme; c. mjete lundrimi të Rojes Bregdetare ose të agjensive ligj-zbatuese në det; d. mjete lundrimi kërkimor shkencor, praktike mësimore; e. mjete lundrimi për qëllime argëtimi - çlodhje në det dhe për qëllime tregtare. Me përfundimin e këtij niveli, individit ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV në KSHK, referuar nivelit III të KEK, (teknik/menaxher) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar të drejtën e diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	J1-III-16			

³ Konventa e Standardeve të Trajnimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Peshkatarët e vitit 1995.

⁴ Konventa e Standardeve të Trajnimit, Certifikimit dhe Shërbimit për Detarët e vitit 1978, e ndryshuar

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Peshkim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë njohuritë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Parapërgatitje e mjetit për lundrim dhe gjueti

- Të përshkruajë strukturën e një mjeti lundruar për peshkim;
- Të përshkruajë materialet e përdorshme dhe funksionet e tyre në mjetin lundruar për peshkim;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të pajisjeve radio-navigacionale që instalohen në një mjet lundrimi peshkimi;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të mjeteve dhe veglave kryesore të punës të instaluar në një mjet lundrimi peshkimi;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të mjeteve të omergjimit, të instaluar në një mjet lundrimi për peshkim;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të mekanizmave të instaluar në kuvertë në një mjet lundrimi për peshkim;
- Të interpretojë sinjalistikën sipas REPAD⁵-it në një mjet lundrimi për peshkim;
- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të mekanizmave të instaluar në lokalin e makinerisë së një mjeti lundrimi për peshkim;
- Të listojë hapat dhe mjetet e nevojshme për matjen e tankeve;
- Të vlerësojë sasinë e rezervave lundrimore në hidrokarbure, ushqim, ujë, etj. për numrin e ekuipazhit dhe kohëzgjatjen e mundshme të lundrimit;
- Të përshkruajë sistemet e komunikimit të brendshëm në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të përshkruajë llojet e ambalazheve të përdorshme për sistemim peshku;
- Të përshkruajë llojet dhe pjesët përbërëse të veglave kryesore të gjuetisë së peshkut me mjete lundruese;
- Të përshkruajë licencat dhe dokumentacionin e anijes para lundrimit për gjueti peshku;
- Të përshkruajë shërbimet për jetëgjatësinë e materialeve dhe veglave të peshkimit në kushtet e anijes;
- Të përshkruajë sistemin e ndriçimit në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të përshkruajë funksionimin e organizimit për gatim në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të vlerësojë kushtet atmosferike, lundrimore, batimetrike, gjeografike, etj. në funksion të planit të gjuetisë;

Mjeti i peshkimit në lundrim

Lundrimi

- Të dallojë formën dhe lëvizjen e tokës, pikat dhe rrathët kryesore, koordinatat gjeografike në funksion të lundrimit;
- Të përshkruajë veçoritë e magnetizmit tokësor, busullën magnetike, ndikimi i saj mbi anije;

⁵ Rregullore e Parandalimit të Përplasjeve të Anijeve në Det

- Të përshkruajë mënyrën e korigjimit dhe kthimit të kurseve dhe pelengjeve;
- Të shpjegojë madhësitë gjatësore për matjen e largësive dhe thellësive në lundrim, si dhe aparatet matëse të tyre;
- Të përshkruajë projeksionet hartografike, shkallën e hartave, leximin e tyre, shtrimin grafik të lundrimit në hartë;
- Të përshkruajë ndikimin e erërave dhe rrymës detare mbi mjetin lundrues;
- Të përshkruajë veçoritë e lundrimit të anijes në rrethana të veçanta si kanale, ngushtica etj.
- Të përshkruajë literaturën lundrimore në funksion të gjuetisë dhe lundrimit;
- Të përshkruajë veçoritë e një feneri të caktuar detar nga karakteristikat e tij;
- Të rendisë rregullat, metodat dhe pajisjet për vrojtimin e peshkut;
- Të shpjegojë planin e gjuetisë të hedhur në hartë sipas koordinatave gjeografike;
- Të përshkruajë funksionet e treguesve të ndryshëm në urën e komandës;
- Të përshkruajë detyrat e shërbimit në marrje, dorëzim dhe gjatë tij në urën e komandës;
- Të argumentojë rëndësinë e vrojtimit, raportimit në kohë dhe qartë në shërbim në urën e komandës;
- Të interpretojë leximet e instrumenteve për parashikimin e motit;
- Të përshkruajë hapat e punës për kalimin e drejtimit në lundrim nga busulla magnetike në autopilot dhe anasjelltas;
- Të listojë urdhrat në timon në terminologjinë shqipe dhe angleze;
- Të listojë terminologjinë e përdorshme në sektorin e kuvertës dhe të makinerisë në mjetin e lundrimit për peshkim;
- Të përshkruajë rastet dhe mënyrat e përdorimit të sistemeve të komunikimit të brendshëm në lundrim;
- Të interpretojë sinjalet e alarmeve dhe rëndësinë e reagimit saktë dhe në kohë;
- Të argumentojë rëndësinë e shmangies së alarmeve të rreme dhe veprimet në rast të një aktivizimi aksidental;
- Të listojë llojet e mjeteve të emergjencës, duke përshkruar përdorimi i tyre;
- Të përshkruajë procedurat për vënien në punë të agregateve kryesore në lokalin e makinerisë së mjetit lundrues për peshkim
- Të përshkruajë detyrat e shërbimit në marrje, dorëzim dhe gjatë tij në lokalin e makinerisë;
- Të argumentojë rëndësinë e vrojtimit, raportimit në kohë dhe qartë në shërbim në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për mos ndotjen e mjedisit detar në shërbim në lokalin e makinerisë;

Manovra

- Të përshkruajë hapat e punës për përdorimin e pajisjeve dhe agregateve në funksion të akostim/ç'akostimit të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë dinamikën e lëvizjes së mjetit lundrues për akostim/ ç'akostim;
- Të argumentojë sigurinë e punës gjatë akostim/ç'akostimit të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë mënyrat e sistemimit të sigurt dhe të rregullt të cimave të akostimit;
- Të përshkruajë përdorimin e gomave mbrojtëse në funksion të akostim/ç'akostimit pa dëme të mjetit lundrues;
- Të përshkruajë vendet dhe mënyrat e vendosjes së mbrojtësve ndaj brejtësve;
- Të interpretojë leximet e telegrafës;
- Të interpretojë leximet e treguesve të presioneve, gazrave, temperaturave etj.
- Të përshkruajë hapat e punës për ndezje/fikje të pompave, kompresorëve, etj.;

- Të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe mënyrat e përdorshme për rimorkimin e mjetit lundrues;
- Të përshkruajë detyrat para, gjatë dhe mbas rimorkimit;

Gjuetia

- Të përshkruajë kriteret e gjuetisë me vegla pasive si kosh, gracka dhe kutia notuese;
- Të përshkruajë bazat teorike të ekuilibrit dhe organizimin e punës në gjuetinë me trata këçi;
- Të përshkruajë teorinë e ndërtimit dhe funksionimit të tratave binjake;
- Të radhisë hapat për gjuetinë me grepa;
- Të shpjegojë procedurat e sigurta të punës për hedhjen/marrjen e veglës së gjuetisë
- Të përshkruajë hapat dhe veglat e punës për kryerjen e riparimeve të thjeshta në kushtet e anijes tek veglat e gjuetisë;
- Të interpretojë leximet e pajisjeve për vrojtimin e peshkut;
- Të përshkruajë vetitë fiziko kimike të ujërave;
- Të përshkruajë parimet dhe shtresat e përhapjes së dritës në ujëra;
- Të përshkruajë karakteristikat dhe veçoritë e organizmave ujorë;
- Të përshkruajë parimet dhe rregullat për gjuetinë specifike që kryen mjete lundrues për peshkim;
- Të përshkruajë parimet dhe rregullat e gjuetisë sportive;
- Të përshkruajë mjetet e gjuetisë sportive dhe procedurat e punës së sigurt me to;

Qëndrimi në spirancë

- Të përshkruajë hapat për vënien në punë të mekanizmit të hedhjes/marrjes së spirancës;
- Të interpretojë shenjëzimin e ndarjes së gjatësive të gadinave të spirancës;
- Të përshkruajë simbolet, dritat dhe vendet e shfaqjes sipas REPAD, gjatë qëndrimit në spirancë;
- Të përshkruajë masat për sigurimin e mekanizmit të spirancës pas hedhjes/marrjes në/nga uji;
- Të përshkruajë praktikën e punës për raportim të drejtimit të gadinës kur spiranca hidhet apo merret nga uji;
- Të përshkruajë detyrat gjatë marrjes së gadinës në mjetin e lundrimit;
- Të përshkruajë detyrat në shërbim në urën e komandës ose në lokalin e makinerisë kur mjete lundrues ndodhet në spirancë;

Shërbime mirëmbajtjeje në sektorin e kuvertës/makinerisë

Kuverta

- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gatishmërisë së mjeteve dhe veglave të punës për punime mirëmbajtëse në kuvertë;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e instruktimit paraprak për përdorimin e mjeteve, veglave dhe planit të punës për mirëmbajtje në kuvertë;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e mbikëqyrjes së zbatimit të planit të punës për mirëmbajtje në kuvertë;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e bashkërendimit të zbatimit të planit të mirëmbajtjes me aktivitete të tjera që ndërthuren në sektorin e kuvertës;
- Të përshkruajë rregullat dhe praktikën për përgatitjen e bojërave për lyrje;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e mirëmbajtjes së pajisjeve të takilazhit, të shpëtimit, MNZ, etj.;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e mirëmbajtjes së pajisjeve të lëvizshme në mbistrukturë;

- Të përshkruajë rëndësinë, praktikat dhe hapat e punës për kryerjen e punimeve në hapësira të mbyllura;
- Të përshkruajë rëndësinë, praktikat dhe hapat e punës për kryerjen e punimeve jashtë bordit ose në lartësi;
- Të përshkruajë praktikat dhe hapat e punës për kryerjen e punimeve mirëmbajtëse dhe riparuese në akomodim;
- Të përshkruajë llojet, veglat dhe hapat e punës për kryerjen e riparimeve të thjeshta të veglave të peshkimit;
- Të përshkruajë skicimin e një vegle të thjeshtë peshkimi;
- Të interpretojë ndërtimin e një vegle të thjeshtë peshkimi;

Makineria

- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e kontrollit paraprak të gatishmërisë së mjeteve dhe veglave të punës për punime mirëmbajtjeje në makineri;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e instruktimit paraprak për përdorimin e mjeteve të punës për mirëmbajtje në sektorin e makinerisë;
- Të argumentojë rëndësinë e mënyrat e mbikëqyrjes së zbatimit të planit të punës për mirëmbajtje në makineri;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e bashkërendimit të zbatimit të planit të mirëmbajtjes me aktivitete të tjera që ndërthuren në sektorin e makinerisë;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e mirëmbajtjes të agregateve në lokalin e makinerisë;
- Të argumentojë rëndësia dhe mënyrat e kontrollit të sigurimit të pjesëve të këmbimit dhe furnizimeve në depo;
- Të përshkruajë parimet dhe hapat e punës së sigurt me sistemet elektrike, pneumatike, hidraulike, etj. në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë procedurat dhe mjetet e punës për zëvendësime të tubacioneve dhe saraçineskave në lokalin e makinerisë;
- Të interpretojë simbolet e aplikueshme në skema në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për përdorimin e agregateve në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës së sigurt për takim/s'takimin e energjisë për agregate të ndryshme nga lokali i makinerisë;
- Të argumentojë rëndësinë e njohjes dhe zbatimit të procedurave të punës, mjeteve, kushteve, individëve pjesëmarrës, reagimin në rast avarie etj., kur i caktohet një detyrë e re nga eprori;
- Të përshkruajë hapat e punës për marrjen e masave për furnizimin me karburant dhe ujë;
- Të përshkruajë hapat e punës për eliminimin e rrjedhjeve nga tubacionet në anije;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe praktikat e aplikueshme për shmangien e ndotjes jashtë bordit nga lokali i makinerisë;
- Të argumentojë rëndësinë dhe mënyrat e mbledhjes së mbetjeve hidrokarbure në lokalin e makinerisë dhe të dorëzimit të tyre në impiantet pritëse portuale;

Riparim-dokimi

- Të përshkruajë llojet dhe mënyrën e llogaritjes së sasive të bojërave që do të aplikohen në karenë (skaf);
- Të përshkruajë hapat për kontrollin e gatishmërisë së veglave të punës për punimet e riparim-dokimit;

- Të përshkruajë hapat e punës për kapjen e cimave, vendosje fashosh ngritëse, raportim qendërzimi të mjetit etj. për daljen në dok të mjetit lundruës;
- Të përshkruajë hapat e punës për pastrimin e pjesës së karenës (skafit) nga bimësia;
- Të përshkruajë gjendjen e karenës pas pastrimit nga bimësia;
- Të përshkruajë hapat e punës për marrjen e njollave me bojë antikorrozive në karenë;
- Të përshkruajë hapat e punës, mjetet dhe materialet për luçidimin dhe grasatimin e fletëve të elikës;
- Të përshkruajë hapat e punës për pastrimin e pikave në skaf ku do të kryhet matje e trashësisë së lamjerës;
- Të përshkruajë hapat e punës së sigurt për uljen e spirancës në tokë;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të imtësishëm të hallkave dhe gambetave lidhëse të gadinës së spirancës;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të sigurimit të gambetës fundore në pusin e gadinës;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe mënyrën e kontrollit të gambetës dhe xhokolinos që lidh gadinën me spirancën;
- Të përshkruajë mënyrën dhe mjetet për markimin e copëve (çelësave) të gadinës;
- Të përshkruajë mënyrën e futjes dhe stivimit në pus të gadinës;
- Të përshkruajë mënyrën e pastrimit të saldimit mbas heqjes së protektorëve të vjetër;
- Të përshkruajë hapat e punës për grasatimin e protektorëve të rinj para lyerjes së karenës;
- Të përshkruajë detyrat në raste të asistencës ndaj specialistit të zëvendësimit të majereve të dëmtuara në skaf ose në kuvertë;
- Të përshkruajë mënyrat e vendosjes së stukos tek hapësirat mes majereve të zëvendësuara ose ku mungon;
- Të përshkruajë hapat e punës për çmontimin dhe montimin e valvolave, tubacioneve, saraçineskave, panjollave në lokalin e makinerisë;
- Të përshkruajë hapat e punës për çmontimin dhe montimin e kapakëve të depove/tankeve të ndryshme;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe praktikat për gatishmërinë e mjeteve të MNZ kur kryhen saldime, zëvendësohen lamiera metalike etj.;
- Të përshkruajë rëndësia dhe praktikat e punës për lyerjen e karenës me bojën antikorrozive dhe antivegetative;
- Të përshkruajë hapat e punës për uljen në ujë të mjetit lundruës mbas dokimit;
- Të përshkruajë hapat e punës për kapjen e cimave, vendosje fashosh ngritëse, raportim qendërzimi të mjetit etj. për uljen nga doku të mjetit lundruës;
- Të përshkruajë rëndësinë dhe praktikat e punës për matjen, raportimin e gjendjes së tankeve apo futjes së ujit nga bokola e “stella-morte-s”, “preso di mare”, etj. mbas uljes në ujë të mjetit lundruës;

Pajisje Radio-Navigacionale

- Të listojë llojet e Pajisje Radio-Navigacionale që instalohen në një mjet lundrimi për qëllime peshkimi;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Radarit në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e autopilotit në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e GPS-së në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Ehollotit në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Sonarit në anijen e peshkimit;

- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Navtex-it në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës, frekuencat dhe funksionin e Radios së instaluar dhe të lëvizshme të bandës VHF në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e Blue Box-it në anijen e peshkimit;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e AIS (sistemi i identifikimit automatik) në anije;
- Të përshkruajë parimin e punës dhe funksionin e xhirobusullës në anije;

Shërbime për aktivitetin ekonomik të peshkimit

- Të përshkruajë mënyrën e seleksionimit dhe sistemit të peshkut mbas gjuetisë;
- Të përshkruajë hapat e punës të trajtimit paraprak për ruajtjen e freskisë së produkteve nga gjuetia deri në dorëzimin në stabilimentet në breg;
- Të përshkruajë sëmundjet kryesore që evidentohen tek peshqit;
- Të përshkruajë shenjat e peshqve të sëmurë nga ato normale;
- Të listojë llojet dhe cilësitë kryesore të peshqve dhe produkteve të tjera detare më të zakonshme në ujërat e Mesdheut;
- Të përshkruajë llojet dhe veçoritë e ambalazheve për produktet nga gjuetia;
- Të përshkruajë treguesit kryesorë për referimin e çmimeve të tregut për lloje specimesh peshku dhe produktesh detare;
- Të përshkruajë treguesit kryesorë për referimin e klientëve potencialë për produktin e pritshëm nga gjuetia;
- Të përshkruajë hapat e punës për vënien dhe ruajtjen e normave të caktuara të impiantit frigoriferik në funksion të ruajtjes së freskisë, sipas llojit të produkteve dhe kohëzgjatjes së gjuetisë;
- Të përshkruajë normat dhe procedurat e punës për raportim të produkteve të zëna nga gjuetia nëpërmjet blue-boxit;
- Të përshkruajë procedurat e dorëzimit në stabilimentet në breg të produkteve të zëna nga gjuetia;
- Të përshkruajë treguesit kryesor për referimin e çmimeve të tregut për veglat, materialet e gjuetisë, karburanteve, ambalazheve etj.
- Të llogarisë një bilanc të thjeshtë të kostove dhe të ardhurave nga gjuetia;
- Të përshkruajë kriteret kryesore ligjore që lidhen me gjuetinë detare;
- Të përshkruajë llojet e gjuetisë sportive që aplikohen në ujërat tona;

Rregullat e sigurimit të jetës, pronës dhe të mbrojtjes së mjedisit

- Të përshkruajë elementët kryesor të rregullores së sigurimit teknik gjatë punës dhe jetesës në bord;
- Të përshkruajë alarmet dhe ushtrimet që organizon komanda e mjetit lundrues;
- Të përshkruajë detyrat personale në alarme dhe ushtrime;
- Të përshkruajë rregullat e higjienës në mjetin e lundrimit;
- Të përshkruajë elementët kryesor të rregullores së kompanisë pronare të mjetit të lundrimit lidhur me organizimin e jetës në mjetin e lundrimit, ruajtjen e jetës, pronës dhe mjedisit;
- Të përshkruajë elementët kryesor për protokolle të caktuara nga kompania pronare e mjetit të lundrimit dhe/ose të autoriteteve në portin e të cilit prek mjeti i lundrimit në kushte pandemie ose të tjera;
- Të përshkruajë rregullat e ndarjes së mbetjeve të ngurta që gjenerohen në bord për dorëzim në impiantet marrëse portuale;
- Të përshkruajë rregullat për raportimin e objekteve dhe njerëzve të panjohur në mjetin e lundrimit;

- Të përshkruajë rregullat për raportimin e objekteve, njerëzve dhe aktiviteteve të dyshimta për rreth mjetit të lundrimit.

Komunikimi në mënyrë etike me të tjerë

- Të përshkruajë kodin e etikës për komunikim në bord dhe në breg;
- Të përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë me të tjerët në bord dhe breg;
- Të përshkruajë teknikat e komunikimit në marrëdhëniet në bord dhe breg;
- Të përshkruajë teknikat e punës në grup në bord dhe breg;
- Të përshkruajë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimin kritik;
- Të përshkruajë rregullat e përdorimit të TIK në komunikimin me të tretët;
- Të përshkruajë terminologjinë detare në bord;
- Të përshkruajë terminologjinë profesionale në anglisht;
- Të argumentojë rëndësinë e respektimit të normave të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare, etj.;

Rezultatet e të nxënit në:

SHPREHI PROFESIONALE

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin mësimor “Peshkim” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individi do të zotërojë shprehitë profesionale të ndara sipas fushave të mëposhtme:

Parapërgatitje e mjetit për lundrim dhe gjueti

- Të kontrollojë gjendjen e sigurisë të mjetit lundrues për peshkim të bregëzuar në port;
- Të kontrollojë gjendjen e gatishmërisë së mjeteve të omergjimit;
- Të kontrollojë gjendjen e veglave të gjuetisë;
- Të provojë gatishmërinë e vinçit të tratës;
- Të provojë gatishmërinë e vinçit të spirancës;
- Të kontrollojë gatishmërinë e timonëve të tratës;
- Të provojë gatishmërinë e poëer block-ut;
- Të vlerësojë gjendjen e rezervës ushqimore dhe ujit të pijshëm në bord në raport me numrin e ekuipazhit dhe kohëzgjatjen e mundshme të gjuetisë;
- Të vlerësojë gjendjen e karburanteve në bord në raport me kohëzgjatjen e mundshme të gjuetisë;
- Të kontrollojë gjendjen e sistemeve dhe impianteve të furnizimit me karburante të mjetit lundrues për peshkim;
- Të vlerësojë gjendjen, sasinë dhe sigurinë e ambalazhit për sistemimin e produkteve nga gjuetia;
- Të provojë gjendjen e punës së frigoriferëve dhe instrumenteve matës të temperaturave;
- Të raportojë gatishmërinë e punës së instrumenteve radio-navigacionalë;
- Të raportojë leximet e instrumenteve matës dhe informativë lidhur me parashikimin e motit për zonën dhe kohëzgjatjen e mundshme të lundrimit;
- Të testojë gatishmërinë e motorëve dhe aggregateve në lokalin e makinerisë;
- Të testojë komunikimin e brendshëm në bord;
- Të kontrollojë gjendjen e mjeteve të shpëtimit të jetës në det;

- Të testojë gatishmërinë e sistemit zjarrfikës;
- Të kontrollojë gjendjen e materialeve të avarive në det;
- Të kontrollojë gjendjen e kompletit të ndihmës së parë;
- Të testojë gjendjen e ndriçimit kryesor dhe të emergjencës të mjetit lundrues për peshkim;
- Të testojë funksionimin e dritave të lundrimit;
- Të kontrollojë sinjalistikën sipas REPAD;
- Të testojë gatishmërinë e kuzhinës;
- Të kontrollojë vlefshmërinë e dokumentacionit të anijes së peshkimit para lundrimit për gjueti peshku;
- Të marrë në konsideratë literaturën lundrimore në funksion të gjuetisë dhe lundrimit;
- Të realizojë shtrimin grafik të lundrimit në hartë për zonën/at e mundshme të gjuetisë;

Mjeti i peshkimit në lundrim

Lundrimi

- Të zbatojë detyrat e shërbimit në marrje, dorëzim dhe gjatë tij në urën e komandës;
- Të raportojë në kohë dhe qartë në shërbim në vrojtim në urën e komandës;
- Të interpretojë leximet e instrumenteve për parashikimin e motit;
- Të realizojë kalimin e drejtimit nga busulla magnetike në autopilot dhe anasjelltas;
- Të përdorë urdhrat në timon në terminologjinë shqipe dhe angleze;
- Të llogarisë korrigjimin dhe kthimin e kurseve dhe pelengjeve;
- Të hedhë në hartë vendndodhjen e mjetit lundrues të matur nëpërmjet pelengjeve dhe instrumenteve navigacionale;
- Të masë madhësi të ndryshme gjatësore që përdoren për matjen e largësive dhe thellësive në lundrim duke përdorur aparatet përkatëse matëse;
- Të marrë në konsideratë korrigjimin e matur të busullës në kursin e lundrimit;
- Të interpretojë leximet e treguesve të xhirove të motorit, të lëvizjes dhe të drejtimit të anijes;
- Të llogarisë ndikimit e erërave dhe rrymës detare mbi mjetin lundrues;
- Të marrë në konsideratë ndikimin e rrymave detare dhe erës në kursin e lundrimit;
- Të hedhë në hartë koordinatat gjeografike sipas planit të gjuetisë;
- Të interpretojë leximet e hartës me fokus rreziqet në zonën e mundshme të lundrimit dhe gjuetisë;
- Të dallojë një fener detar nëpërmjet karakteristikave të tij;
- Të kryejë shërbime në kuvertë në rrethana të veçanta;
- Të përdorë instrumentet radio-navigacionale në funksion të lundrimit;
- Të raportojë për gjendjen e sigurisë në kuvertë dhe depo para dhe pas motit të keq;
- Të zbatojë detyrat e shërbimit në marrje, dorëzim dhe gjatë tij në lokalin e makinerisë;
- Të raportojë ecurinë e punës në kohë dhe qartë në shërbim në lokalin e makinerisë;
- Të përdorë agregatat në lokalin e makinerisë sipas procedurave të përcaktuara;
- Të përdorë sistemet e filtrimit, transferimit dhe akumulimit të mbetjeve në lokalin e makinerisë;
- Të përdorë vendkalime të sigurta gjatë shërbimit në bord;
- Të përdorë mjetet e komunikimit të brendshëm në bord;
- Të veprojnë saktë dhe në kohë sipas detyrave vetjake në raste alarmesh;
- Të shmangë aktivizimin e alarmeve të rreme;
- Të kryejë veprimet e duhura në rast të një aktivizimi aksidental të alarmit;
- Të përdorë mjetet e emergjencës në raste nevojë;
- Të ruajë mjedisin detar në shërbim në lokalin e makinerisë duke zbatuar udhëzimet përkatëse;

Manovra

- Të përdorë pajisjet dhe agregatet në funksion të akostim/ç'akostimit të mjetit lundrues;
- Të raportojë saktë dinamikën e lëvizjes së mjetit lundrues për akostim/ ç'akostim;
- Të marrë masat e sigurisë në punë gjatë akostim/ç'akostimit të mjetit lundrues;
- Të mbikëqyrë sistemimin e sigurt dhe të rregullt të cimave të akostimit;
- Të mbikëqyrë përdorimin e gomave mbrojtëse në funksion të akostim/ç'akostimi pa dëme të mjetit lundrues;
- Të mbikëqyrë vendosjen e mbrojtësve ndaj brejtësve;
- Të raportojë leximet e telegrafës;
- Të interpretojë leximet e treguesve të presioneve, gazrave, temperaturave etj.
- Të realizojë ndezjen/fikjen e pompave, kompresorëve, etj.;
- Të përgatisë veglat dhe mjetet për rimorkimin e mjetit lundrues;
- Të zbatojë detyrat para, gjatë dhe mbas rimorkimit;

Gjuetia

- Të zbatojë kriteret e gjuetisë me vegla pasive si kosh, gracka dhe kutia notuese;
- Të zbatojë bazat teorike të ekuilibrit dhe organizimit të punës në gjuetinë me trata qiçi;
- Të zbatojë kriteret e gjuetisë me trata binjake;
- Të zbatojë kriteret e gjuetisë me grepa;
- Të zbatojë hapat e punës së sigurt për hedhjen/marrjen e veglës së gjuetisë;
- Të kryejë riparime të thjeshta në kushtet e anijes tek veglat e gjuetisë;
- Të interpretojë leximet e pajisjeve për vrojtimin e peshkut;
- Të interpretojë vetitë, dukshmërinë, praninë e mikro-organizmave, etj. të ujit të detit në zonën e gjuetisë që duken me sy;
- Të zbatojë parimet dhe rregullat për gjueti specifike;
- Të zbatojë parimet dhe rregullat e gjuetisë sportive;
- Të përdorë mjetet e gjuetisë sportive;
- Të kryejë lidhjen e thesit të tratës
- Të punojë në grup për hedhjen dhe marrjen e veglave për peshkim
- Të përdorë vinçin për hedhjen /mbledhjen e tratës
- Të vlerësojë leximet e instrumenteve dhe kushtet rrethore për praninë e peshkut;
- Të hedhë në hartë koordinatat gjeografike sipas planit të gjuetisë;
- Të asistojë në marrjen e masave për ruajtjen e jetëgjatësisë së veglave të peshkimit në anije;

Qëndrimi në spirancë

- Të përdorë mekanizma të hedhjes/marrjes së spirancës;
- T'i raportojë kapitenit shenjëzimin e ndarjes së gjatësive të gadinave të spirancës;
- Të vendosë simbolet, dritat dhe vendet e shfaqjes sipas REPAD, gjatë qëndrimit në spirancë;
- Të marrë masat për sigurimin e mekanizmit të spirancës pas hedhjes/marrjes në/nga uji;
- Të raportojë drejtimin e gadinës kur spiranca hidhet apo merret nga uji;
- Të zbatojë detyrat gjatë marrjes së gadinës në mjetin e lundrimit;
- Të zbatojë detyrat në shërbim në urën e komandës ose në lokalin e makinerisë kur mjeti lundrues ndodhet në spirancë;

Shërbime mirëmbajtjeje në sektorin e kuvertës/makinerisë

Kuverta

- Të testojë paraprakisht gatishmërinë e mjeteve dhe veglave për punime mirëmbajtëse në kuvertë;
- Të kryejë instruktimin paraprak për përdorimin e mjeteve, veglave dhe planit të punës për mirëmbajtje në kuvertë;
- Të mbikëqyrë zbatimin e planit të punës për mirëmbajtje në kuvertë;
- Të bashkërendojë zbatimin e planit të mirëmbajtjes me aktivitete të tjera që ndërthuren në sektorin e kuvertës;
- Të përgatisë bojërat për lyrje;
- Të kryejë mirëmbajtje të pajisjeve të takilazhit, të shpëtimit, MNZ, etj.;
- Të kryejë mirëmbajtje të pajisjeve të lëvizshme në mbistrukturë;
- Të kryejë punime mirëmbajtëse në hapësira të mbyllura;
- Të kryejë punime mirëmbajtëse jashtë bordit ose në lartësi;
- Të kryejë punime mirëmbajtëse dhe riparuese në akomodim;
- Të kryejë riparime të thjeshta të veglave të peshkimit;
- Të ndërtojë një vegël të thjeshtë peshkimi;

Makineria

- Të testojë paraprakisht gatishmërinë e mjeteve dhe veglave për punime mirëmbajtëse në lokalin e makinerisë;
- Të kryejë instruktimin paraprak për përdorimin e mjeteve të punës për mirëmbajtje në sektorin e makinerisë;
- Të mbikëqyrë zbatimin e planit të punës për mirëmbajtje në makineri;
- Të bashkërendojë zbatimin e planit të mirëmbajtjes me aktivitete të tjera që ndërthuren në sektorin e makinerisë;
- Të kryejë punime mirëmbajtje të agregateve në lokalin e makinerisë;
- Të kryejë kontrollin e sigurimit të pjesëve të këmbimit dhe furnizimeve në depo;
- Të kryejë punime mirëmbajtëse të thjeshta me pajisjet elektrike, pneumatike, hidraulike etj. në lokalin e makinerisë;
- Të kryejë zëvendësime të tubacioneve dhe saraçineskave në lokalin e makinerisë;
- Të organizojë punën për kryerjen e markimeve të sistemeve dhe agregateve të instaluara;
- Të interpretojë simbolet e aplikueshme në skema në lokalin e makinerisë;
- Të marrë masat e sigurisë për punime saldimi në lokalin e makinerisë;
- Të vë në punë agregatet në lokalin e makinerisë;
- Të kryejë takime/s'takime të energjisë për agregate të ndryshme nga lokali i makinerisë;
- Të instruktojë procedurat e punës, përdorimin e mjeteve, kushtet, individët pjesëmarrës, reagimin në rast avarie etj., kur caktohet një detyrë e re;
- Të marrë masat për furnizimin me karburant dhe ujë;
- Të realizojë eliminimin e rrjedhjeve nga tubacionet në anije;
- Të zbatojë praktikatat e punës për shmangien e ndotjes jashtë bordit nga lokali i makinerisë;
- Të kryejë mbledhjen e mbetjeve hidrokarbure në lokalin e makinerisë;
- Të kryejë dorëzimin e mbetjeve hidrokarbure në impiantet pritëse portuale;

Riparim-dokimi

- Të llogarisë sasinë dhe llojin e bojërave që do të aplikohen në karenë (skaf);

- Të përgatisë bojërat për lyerje që do të aplikohen në karenë (skaf);
- Të kryejë kontrollin e gatishmërisë së veglave të punës për punimet e riparim-dokimit;
- Të punojë në grup për kapjen e cimave, vendosje fashosh ngritëse, raportim qendërzimi të mjetit etj. për daljen në dok të mjetit lundrues;
- Të organizojë punën për pastrimin e pjesës së karenës (skafit) nga bimësia;
- Të raportojë gjendjen e karenës pas pastrimit nga bimësia;
- Të organizojë punën për marrjen e njollave me bojë antikorrozive në karenë;
- Të kryejë lucidimin dhe grasatimin e fletëve të elikës;
- Të kryejë pastrimin e pikave në skaf ku do të kryhet matje e trashësisë së lamjerës;
- Të organizojë punën për uljen e sigurt të spirancës në tokë;
- Të kryejë kontrollin e imtësishëm të hallkave dhe gambetave lidhëse të gadinës së spirancës;
- Të kontrollojë lidhjen e sigurt të gambetës fundore në pusin e gadinës;
- Të kontrollojë lidhjen e sigurt të gambetës dhe xhokolinës që lidh gadinën me spirancën;
- Të organizojë punën për markimin e copëve (çelësave) të gadinës;
- Të organizojë punën për futjen dhe stivimin në pus të gadinës;
- Të kryejë pastrimin e mbetjeve nga saldimi i mëparshëm mbas heqjes së protektorëve të vjetër;
- Të organizojë punën për grasatimin e protektorëve të rinj para lyerjes së karenës;
- Të asistojë specialistin e zëvendësimit të majereve të dëmtuara në skaf ose në kuvertë;
- Të realizojë vendosje të stukos tek hapësirat mes majereve të zëvendësuara ose ku mungon;
- Të kryejë çmontimin dhe montimin e valvolave, tubacioneve, saraçineskave, panjollave në lokalin e makinerisë;
- Të kryejë çmontimin dhe montimin e kapakëve të depove/tankeve të ndryshme;
- Të marrë masat për gatishmërinë e mjeteve të MNZ kur kryhen saldime, zëvendësohen lamiera metalike etj.;
- Të organizojë punën për lyerjen e karenës me bojën antikorrozive dhe antivegetative;
- Të organizojë punën për uljen në ujë të mjetit lundrues mbas dokimit;
- Të punojë në grup për kapjen e cimave, vendosje fashosh ngritëse, raportim qendërzimi të mjetit etj. për uljen nga doku të mjetit lundrues;
- Të kryejë matjen, raportimin e gjendjes së tankeve apo futjes së ujit nga bokola e “stella-morte-s”, “preso di mare”, etj. mbas uljes në ujë të mjetit lundrues;

Pajisje Radio-Navigacionale

- Të interpretojë leximin e radarit në raport me objektet përreth anijes;
- Të interpretojë leximin e autopilotit në anije;
- Të interpretojë leximin e GPS-së në anije;
- Të interpretojë leximin e Ehollotit në anije;
- Të interpretojë leximin e Sonarit në anijen e peshkimit;
- Të interpretojë leximin e Navtex-it në anije;
- Të përdorë rregullat e komunikimit detar me radion e instaluar dhe të lëvizshme të bandës VHF në anije;
- Të përdorë Blue Box-in për raportimin e aktivitetit nga gjuetia në anijen e peshkimit;
- Të interpretojë leximin e AIS (sistemi i identifikimit automatik) në anije;
- Të interpretojë leximin e xhirobusullës në anije;

Shërbime për aktivitetin ekonomik të peshkimit

- Të mbikëqyrë larjen dhe pastrimin e produktit të zënë nga gjuetia;
- Të veçojë peshqit e sëmurë;
- Të seleksionojë sipas llojit produktin e zënë nga gjuetia;
- Të kryejë ndarjen sipas cilësisë produktin e zënë nga gjuetia;
- Të sistemojë në ambalazhe produktin e zënë nga gjuetia sipas llojit dhe cilësisë;
- Të kryejë akulllosjen e produkteve të zëna nga gjuetia;
- Të kryejë numërimin fizik të produkteve nga gjuetia;
- Të vendosë produktin në frigorifer sipas temperaturave përkatëse të produkteve;
- Të raportojë periodikisht temperaturën e frigoriferit sipas kërkesave të produkteve;
- Të shënojë në ditarin e mjetit lundrues për peshkim/blue box sasinë dhe llojet e produktit të zënë;
- Të shkarkojë produktet e zëna nga gjuetia;
- Të sistemojë arkat sipas llojit dhe cilësisë në magazinë;
- Të kryejë peshime të sasisë së produktit të zënë;
- Të mbajë evidenca për sasinë, për cilësitë, çmimet, klientët etj.;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të shpenzimeve dhe të ardhurave nga gjuetia;

Rregullat e sigurimit të jetës, pronës dhe të mbrojtjes së mjedisit

- Të zbatojë rregulloren e sigurimit teknik gjatë punës dhe jetesës në bord;
- Të marrë pjesë në alarmet dhe ushtrimet që organizon komanda e mjetit lundrues;
- Të zbatojë detyrat personale në alarme dhe ushtrime;
- Të zbatojë rregullat e higjienës në mjetin e lundrimit;
- Të zbatojë rregulloren e kompanisë pronare të mjetit të lundrimit lidhur me organizimin e jetës në mjetin e lundrimit, ruajtjen e jetës, pronës dhe mjedisit;
- Të zbatojë protokollat e caktuara nga kompania pronare e mjetit të lundrimit dhe/ose të autoriteteve në portin e të cilit prek mjeti i lundrimit në kushte pandemie ose të tjera;
- Të zbatojë rregullat e ndarjes së mbetjeve të ngurta që gjenerohen në bord për dorëzim në impiantet marrëse portuale;
- Të raportojë objekte dhe njerëz të panjohur në mjetin e lundrimit;
- Të raportojë objekte, njerëz dhe aktivitete të dyshimta për rreth mjetit të lundrimit.

Komunikimi në mënyrë etike me të tjerë

- Të zbatojë kodin e etikës për komunikim në bord dhe në breg;
- Të komunikojë me etikë me të tjerët në bord dhe breg;
- Të përdorë teknikat e komunikimit në marrëdhëniet në bord dhe breg;
- Të zbatojë teknikat e punës në grup në bord dhe breg;
- Të zbatojë teknikat e zgjidhjes së problemeve dhe mendimin kritik;
- Të përdorë TIK në komunikimin me të tretët;
- Të përdorë terminologjinë detare në bord;
- Të përdorë terminologjinë profesionale në anglisht;
- Të zbatojë normat e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare, etj.;

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Individi duhet të jetë i aftë:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efeciente;
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejt procesin e të nxënimit të tij/saj dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë eficiente me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.